



10-16 MARS

JAVA E MBROJTJES



GJENERALËT E RINJ TË FA

Forcave të Armatosura u shtohen edhe gjashtë ushtarakë me grada të larta. Me **dekret të presidentit** të Republikës, njëherësh komandant i Përgjithshëm i FA dhe me **propozim të ministrit të Mbrojtjes**, gjeneral brigade Ferdinand Dimo dhe Petrit Çuni tashmë do të mbajnë gradën **gjeneralmajor**. Kundëradmiral **Adnand Agastra** do të mbajë gradën nënadmiral, ndërsa kolonelët **Ardian Lilo**, Vehbije Kuti dhe **Hamdi Doda** do të mbajnë gradën madhore gjeneral brigade.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

STËRVITJE E PËRBASHKËT SHQIPËRI - SHBA

Efektivë të Forcave të Armatosura të Shqipërisë dhe ushtarët dhe aviatorët e Gardës Kombëtare të **Nju Xhersit** kanë zhvilluar një **stërvitje** të përbashkët. E pranishme në këtë stërvitje ishte edhe e ngarkuara me punë e **Ambasadës së SHBA**, Van Horn, e cila **vëzhgoi** ekipet tona duke pilotuar dronët dhe duke u trajnuar me kompaninë e mortajave të **FARSH**.



mod.gov.al

JM



TAKIM ME MINISTRIN E MBROJTJES SË KOSOVËS

Ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu, zhvilloi një takim informal me homologun e tij nga Kosova, Ejup Maqedonci. Në qendër të diskutimeve ishte forcimi i bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes midis dy vendeve. Në kushtet e një mjedisi të brishtë sigurie, të dy ministrat theksuan rëndësinë e konsultimeve të përbashkëta, duke i cilësuar ato si një përparësi strategjike.

JM





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

TAKIME ME TË RINJTË

Qendra e Personelit të Rekrutimit, në bashkëpunim me Akademinë e Forcave të Armatosura, **organizuan** “Ditë të Hapura” me të rinjtë në **Vlorë**, Orikum dhe Selencë. Ata patën mundësinë të **njihen** nga afër me rolin dhe misionin e FA-së, si dhe me mundësitë për t’u bërë pjesë e **tyre**.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

DY URA TË REJA “BAILEY”

Forcat **xheniere**, pjesë e Forcave të Armatosura, kanë përfunduar me sukses ndërtimin e dy urave tip “**bailey**”, duke **përmbushur** nevojat e komunitetit në dy zona të ndryshme të vendit. Ura në lagjen Klos, në fshatin Fan, të **Mirditës** do t’u shërbejë rreth **600 banorëve** të zonës. Ndërsa ura në lagjen Caraj, Perlat i Epërm, lidh rreth **450 banorë**.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

ZËVENDËSMINISTRJA ABRAZHDA VIZITON TRUPAT E KFOR

Zëvendësministrja e Mbrojtjes, **Blerina Abrazhda**, vizitoi **Pejën**, ku takoi efektivët e Forcës Tokësore që shërbejnë në misionin e **KFOR**, të drejtuar nga NATO. Ajo zhvilloi një takim edhe me **komandantin** e bazës, kolonel Francesco Errico, të cilin e falënderoi për **leadershipin** dhe mbështetjen e **vazhdueshme** ndaj kontingjenteve shqiptare me mision në KFOR, në **Pejë, Kosovë**.





PANAIRI “WORK & STUDY”

Në Krujë, Durrës, Kavajë, Berat, Elbasan, u zhvillua panairi “Work & Study”, një mundësi e shkëlqyer për të rinjtë që kërkojnë mundësi studimi dhe punësimi. Gjatë aktiviteteteve, Akademia e Forcave të Armatosura dhe Qendra e Personelit të Rekrutimit prezantuan programet e studimit dhe mundësitë e punësimit, duke ofruar një rrugë të shkëlqyer për ata që janë të interesuar për një karrierë me disiplinë, sfida dhe mundësi zhvillimi.

★★★★★